



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



## KOMUNA E PRISHTINËS

03/673-53

Dt. 12.03.2025

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit nr. 03/L-0 për Arsimin në Komunat e Republikës të Kosovës dhe në bazë të dhe Rregulloren (QRK) Nr. 19/2024 , Drejtoria Komunale e Arsimit shpallë këtë:

***DREJTORIA E ARSIMIT RISHPALL  
THIRRJE PUBLIKE  
PËR PËRZGJEDHJEN E EKSPERTIT TË PAVARUR TË ARSIMIT  
APO PËRFAQËSUESIT TË KËSHILLIT TË PRINDËRVE ME  
KUALIFIKIM DHE EKSPERTIZË NË FUSHËN E ARSIMIT  
NË KOMISIONIN PËR REKRUTIMIN E DREJTORËVE  
DHE ZËVENDES DREJTORËVE TË IEAA***

### DREJTORIA E ARSIMIT

**Titulli:** Ekspert i pavarur i arsimit apo përfaqësues i Këshillit të Prindërve me kualifikim dhe ekspertizë në fushën e Arsimit në Komisionin Përzgjedhës për rekrutimin e drejtorëve dhe zv.drejtorëve të IEAA-ve;

**Kohëzgjatja e emërimit:** 12 muaj,  
Ekspertët do të paguhen sipas legjislacionit ne fuqi.

**Qëllimi i vendit të punës:** Zhvillimi i procedurave të rekrutimit të drejtorëve dhe zv.drejtorëve të IEAA-ve.

## **DETYRAT KRYESORE TË PUNËS:**

- Të sjellin njohuri mbi sfidat, çështjet dhe mundësitë brenda fushës së tyre të pranuar të ekspertizës dhe se si kjo lidhet me institucionet publike;
- Të marrin pjesë në takime, informime rreth procesit të rekrutimit dhe praktikave për të maksimizuar vlerësimin e të bazuar në meritë;
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Kryesuesin dhe anëtarët tjerë të Komisionit;
- Konsultim transparent në proceset e rekrutimit;
- Të marrin pjesë në proceset e listave të ngushta;
- Të marrin pjesë në procesin e testit me shkrim;
- Plotësimin e formularëve standard të përcaktuar për drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Vlerësimi i kandidatëve për përgjegjësinë ekzekutive në menaxhim dhe administrim të institucionit edukativo-arsimor;
- Vlerësimi i Planit Zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor të kandidatëve për drejtues të IEAA-ve;
- Të ngritin shqetësimet me Kryesuesin e Komisionit në rastet e praktikave joefektive të përzgjedhjes, çështjet e integritetit, transparencës apo veprimeve që janë në kundërshtim me vlerësimin e bazuar në meritë;
- Të ruajnë konfidencialitetin e duhur të materialeve dhe përmbajtjeve të procesit të rekrutimit gjatë zhvillimit të të gjitha proceseve të rekrutimit;
- Të tregojnë profesionalizëm në emër të Komisionit;
- Analiza dhe shqyrtimi i legjislacionit primar dhe sekondar në fushën e arsimit;
- Parashtrimi i procesverbalit dhe vlerësimi përfundimtar për secilin kandidat;
- Respektimi i afateve kohore të parashtruara në legjislacionin në fuqi.

## **Kushtet:**

- Të jetë shtetas i Republikës të Kosovës;
- Të ketë të kryer arsimin pasuniversitar të nivelit: Master (300 ECTS) në menaxhim, politika publike, arsim, apo të ngjashme;
- Të ketë të përfunduar certifikim në fushën arsimore apo menaxhim (e preferuar);
- Të kenë përvojë në përfaqësimin e fushave të ekspertizës në nivel kombëtar ose ndërkombëtar siç janë grupet punuese, komisionet e BE-së, kontributet për ligjet ose rregulloret përkatëse;
- Të ketë njohuri të legjislacionit primar dhe sekondar të procedurave rekrutuese;
- Të ketë pozitë udhëheqëse (Nivel Drejtori/Kryeshefi, emërim në Bord apo Drejtues Profesionist) në organizatë joqeveritare vendore apo ndërkombëtare për arsim së paku për tri vite për ekspertët e arsimit; të ketë pozitë udhëheqëse në sektorin privat apo publik për tri vitet e fundit për anëtarët e këshillit të prindërve;

- Përvojë pune si anëtar bashkëpunues në grupe punuese shumë-disiplinore – i/e aftë për të sjellë ekspertizë profesionale dhe sfiduar të tjerët pozitivisht;
- Të ketë së paku tre (3) vite përvojë pune në fushën e arsimit për ekspertët e jashtëm; të jetë së paku një mandat anëtar në këshillin e prindërve për anëtarët e këshillit të prindërve;
- Të mos jetë nën hetime nga organet ligjvënëse;
- Të mos jetë anëtar/e i ndonjë subjektit politik në tre (3) vitet e fundit;

#### **Dokumentet e domosdoshme:**

- Dokumentet personale (certifikata e lindjes dhe letërnjoftimi);
- Diploma e fakultetit të kryer për nivelin e kërkuar të kualifikimit;
- Dëshmi e përvojës së punës në nivel drejtues/pozitiv udhëheqëse;
- Certifikatat e trajnimeve në fushën arsimore të licensuara;
- Certifikata/dëshmi të trajnimeve në zhvillimin e procedurave rekrutuese;
- Certifikata e regjistrimit dhe letërkonfirmimi i organizatës në të cilën bën pjesë;
- Dëshmi të përvojës së punës në fushën e arsimit;
- Certifikatën që nuk është nën hetime nga Gjykata Themelore;
- Deklaratën nën betim për mospjesëmarrje në aktivitetet politike në tre (3) vitet e fundit;

#### **Mënyra e aplikimit**

- **Data e shpalljes së Thirrjes Publike 12.03.2025 deri më dt. 19.03.2025**
- Aplikacionet merren dhe dorëzohen në kopje fizike në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës;
- Në aplikacion duhet të specifikohet qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkëngjitura aplikacionit duhet të jenë kopje dhe nuk kthehen;
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, përvojës së punës dhe dokumentacionet tjera të nevojshme të kërkuara sipas kushteve të Thirrjes publike;
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen;

- Inkurajohen gratë dhe anëtarë/e të komuniteteve joshumicë të aplikojnë në parashtrimin e kësaj thirrjeje publike;
- Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni Drejtorinë e Arsimit [Anita.Xhabiri@rks-gov.net](mailto:Anita.Xhabiri@rks-gov.net) , rr. Andrea Gropa, nr. 40 , telefoni: 038 231 870.